

BIO E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

ROBERTO R. MUNOZ

Roberto R. Muñoz, njëkohësisht edhe Kryetar i Komitetit të Kontrollit të ABI Bank, me eksperiencë financiare më shumë se 35 vjet si drejtues si President i The Global Financial Group, duke u përqendruar kryesisht në menaxhimin e Individëve me Vlerë Neto të Lartë dhe Kompani të Tregut të Mesëm me synim shënjestrimin dhe rritjen e aktivitetit, nëpërmjet strategjive të planifikimit dhe ekzekutimit strategjik. Së fundmi, ai ka punuar si President i Miami Market për Bankingun Tregtar dhe Manaxhimin e Pasurive në First Horizon Bank me zyra qendrore në Memphis, Tennessee dhe më parë si drejtues grupi për Bankingun Tregtar dhe Manaxhimin e Pasurive për Floridën e Jugut, për Synovus Bank.

Gjatë karrierës së tij bankare, Z. Muñoz ka punuar për aktivitete ekonomike me vlerë për më shumë se \$27 bilion në Florida, Karaibe, Amerikën Qendrore dhe Amerikën Jugore, në fushat e bankingut tregtar përfshirë huadhënien për korporata të mëdha dhe të tregut të mesëm, huadhëniet institucionale dhe të specializuara, si dhe shërbimet globale të manaxhimit të pasurive dhe thesarit. Z. Muñoz ka mbajtur pozicione ekzekutuese në BBVA Bank (President, Tregu i Floridës Jugore), Professional Bank (CLO dhe Senior EVP), Marquis Bank (CEO, President, CLO dhe Anëtar Votues i Bordit Drejtues), Regions Bank (Drejtor i Lartë Menaxhues dhe Menaxher i Lartë i Shitjeve), Israel Discount Bank (CLO për Florida), Mizuho Bank (Përfaqësuesi Kryesor) dhe Barclays Capital, PLC. Ai e filloi karrierën e tij me Bankën e Amerikës në vitin 1980.

Z. Muñoz është kryetar për vitin 2019 dhe 2020 i World Trade Center Miami, dhe mban pozicione drejtuese në Organizata qytetare të tjera në Floridën Jugore. Ai është nënkryetar i parë i bordit ekzekutiv të Dhomës së Tregtisë së Madhe në Miami, në bordin ekzekutiv të Këshillit Miami-Dade Beacon dhe ish-kryetar dhe president i Shoqatës Ndërkombëtare të Bankierëve të Floridës.

Ai është gjithashtu pjesë e bordeve këshilluese dhe ekzekutive të The Center for Financial Training International, bordit këshillues të Qendrës për Lidërsip në Universitetin Ndërkombëtar të Floridas, bordin këshillues të shkollës Tibor and Sheila Hollo për pasuritë e paluajtshme në Universitetin Ndërkombëtar të Floridas, në bordin e shoqatës Florida Alternative Investment dhe është administrues i Miami-Dade County, qyteti i Miamit, North Bay Village dhe Fondacionit Zoo Miami.

Në komunitet, z. Muñoz është president i zgjedhur i Këshillit të Floridës Jugore, Zbuluesit (Scouts) e Amerikës, kryetar i Komitetit për nderimin e Qytetarëve të Dalluar; anëtar bordi i Chapman Partnership për të pastrehët dhe anëtar bordi i besuar i Shoqatës së Leukemisë dhe Limfomës së Floridës së Jugut.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al

Ai ka marrë çmime dhe mirënjohje të shumta duke përfshirë çmimin "Kampion i Mbikëqyrjes" 2020 nga Fondacioni Miami Zoo në Shtator 2020, në Marquis Who's Who në Amerikë në Korrik 2020 dhe çmimin "Arritje jetësore" në "Second Century Society" nga Këshilli i Floridës së Jugut, Zbulues (Scouts) i Amerikes në Dhjetor 2019. Ai ka marrë çmimin "Shërbimi Publik dhe Kapiteni i Industrisë" në Tregtinë dhe Bankën Globale nga Organizata CSC, Triple C në Korrik 2019 si pjesë e Iniciativës së Kombeve të Bashkuara për ditën e shërbimeve. Z. Muñoz mori çmimin "Rrethi i Diamantit" për vitin 2019, për Lidërsip dhe Manaxhim nga First Horizon Bank në Shkurt 2020. Ai u emërua dy herë "The Achiever" nga *Miami Today* në Shkurt 2020 dhe në Maj 2014, dhe mori çmimin "Bankieri i Vitit" nga Dhoma e Tregtisë Hispanike e Floridës së Jugut në Mars 2020. Me më shumë se 30,000 kontakte në LinkedIn, zoti Muñoz ka një ndjekje të gjerë sociale dhe poston rregullisht për një sërë temash.

Z. Muñoz ka lindur në Panama me prindër Amerikane dhe ka jetuar në Hong Kong për gjashtë vjet. Ai është diplomuar në Financë dhe Biznes Ndërkombëtar në Universitetin Ndërkombëtar të Floridas, ka marrë një diplomë të asociuar nga Miami- Dade College dhe diplomë të shkollës së mesme nga Miami Springs Senior High. Ai ka një sërë diplomash dhe certifikata në fushën e bankingut. Ai dhe gruaja e tij Teresa kanë pesë fëmijë dhe janë emëruar "Prindërit e Vitit" nga shkolla publike Miami-Dade në vitet 2019, 2018 dhe 2017. Përveç kalimit të kohës me familjen e tij, z. Muñoz pëlqen të gatuajë, të udhëtojë të njihet me kultura të ndryshme. Ai flet rrjedhshëm anglisht dhe spanjisht.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al